



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 65/Prot.
4

Tiranë, më 12.08.2024

NJOFTIM PUBLIK

**“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR
Z.RAMADAN ÇEPELE NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 62-2024-1685 (2620) DATË
29.03.2024 TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR FIER”**

Adresa: Lagjia Nr.2, Bashkia Roskovec

Referuar vendimit nr. 62-2023-1187 (214), datë 07.04.2023 të Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku znj. Rezarta Muçaj është përfituese e Ndihmës Juridike Dytësore, referuar procesit gjyqësor me objekt “*Kërkesë për ndihmë juridike dytësore, caktim avokati dhe për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore*”.

Me Vendimin nr.62-2024-1685 (2620), datë 29.03.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në procesin penal me viktimë akuzuese znj. Rezarta Muçaj dhe të akuzuar z. Ramadan Çepele me objekt “*Mosdhënien e mjeteve për jetesë*” ka vendosur:

- 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit.*
- 2. Në pikën 5 të dispozitivit të vendimit gjyqësor shpenzimet proceduriale i ngarkohen të pandehurit Ramadan Çepele që konsistojnë në pagimin e tarifës në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë, të parapaguara nga Drejtoria e Ndihmës juridike.**

Në Vendimin përfundimtar gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të të pandehurit z.Ramadan Çepele.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimet e ofruara Av. Erlis Nakollari me vlerë 20.000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Proçedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me nr. 62-2024-1685 (2620), datë 29.03.2024, të shumës prej 20.000 lekë, të parapaguara nga ana jonë për shpërblim avokati, ofruar për përfituesin e ndihmës juridike dytësore falas znj. Rezarta Muçaj.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me NIPT L11704452P.

...ast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbartimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Ramadan Çepele.

Në këto kushte referuar nenit 146 të Kodit të procedurës Administrative, kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Bashkinë Rosovec, Lagjia Nr 2, si dhe në faqen Eëb të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë.

Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Roskovec depoziton në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**DREJTOR I FINANCËS
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Lefkothea Lite

